

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** **" ROYAL OLIVE 2024 "**

Sot më datë **13.06.2024**, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, në cilësinë e Ortakut të Vetem Themelues:

- 1. Z. Arken Brami, atesia Lulezim, shtetas shqiptar, lindur me 01.03.1999 në Berat , dhe banues në Fshatin Dushnik , Berat , madhor me zotesi juridike për të vepruar, i identifikuar me nr personal me J90301001R.**

Deklaroj se kam vendosur të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë referuar si Shoqëria), me termat e mëposhtëm:

#### **Neni 1 Emërtimi**

Shoqëria emërtohet "**ROYAL OLIVE 2024**" SH.P.K. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

#### **Neni 2 Selia**

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Qarku Berat,,Fshati Dushnik,godina numer pasurie 1658/37 ,Zone kadastrale 1587, kodi postar 5010.

#### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:**

- Fabrike për perpunimin e ullirit.Grumbullim dhe perpunim ulliri .**
- Tregtim i mallrave industrial e bujqësor me shumice e pakice.**
- Tregeti e pergjithshme, import – eksport sipas legjislacionit ne fuqi.**

## **Neni 5 Kapitali themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 15,000,000 (Pesëmbëdhjete milion) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) kuote kapitali i ndarë në:**

- **Z. Arken Brami 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 15,000,000 (Pesëmbëdhjete milion) lekë.**

## **Neni 6 Kontributet e Kapitalit themeltar**

**Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtëme:**

- **Z. Arken Brami ka kontribuar në para në shumën 15,000,000 Pesëmbëdhjete milion) lekë.**

**Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:**

- **Z. Arken Brami është zotërues i 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 15,000,000 (Pesëmbëdhjete milion) lekë ose 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

## **Neni 7 Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

## **Neni 8 Administrimi**

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizike, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme.

**Administratoria e parë e shoqërisë është znj.Alda Brami, shtetas shqiptar, lindur më 24.12.1991 në Berat dhe banues në në Fshatin Dushnik , Berat, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaport me Nr.BR0840462 dhe Nr. personal J16224056B .**

Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

**Neni 9**  
**Të tjera**

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**Neni 10**  
**Kundërshtimet**

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

**Neni 11**

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “ROYAL OLIVE 2024” SH.P.K.**

**ARKEN BRAMI**

Arken Brami  
